



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – sherbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Studim Projektim “Ndertimi i Kanalizimeve te njesise administrative Cerrave, Bashkia Pogradec”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Projekte 22114311-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9 997 866.67 (nente milion e nenteqind e nentedhjet e shtate mije e teteqind e gjashtedhjet e gjashte pike gjashtedhjet e shatate ) leke pa tvsh,**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale **Ujesjelles Kanalizime sha Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës shtojca 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2020,2021,2022), nga data e zhvillimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, e cila duhet të jetë jo më e vogël se 3 999 146.67 leke e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti koontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020,2021,2022) të paraqitura në autoritet përkatëse përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet.**ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë

detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, me një vlerë *jo më të vogël se 30%* e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me entet publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me entin publik, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.ose
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes *(ku të shprehen qarte datat,shumat dhe shërbimet e realizuara).*

**Argumentimi::** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 *(ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b)*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 30% të fondit limit.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:**

**Liçensa profesionale të shoqërisë ( e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

- **3 a**, *Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.*
  - **5 b**, *Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.*
  - **5 c**, *Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.*
  - **6 a**, *Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.*
  - **8 a**, *Rivelime inxhinierike.*
  - **8 b**, *Rilevime inxhinierike kadastrale.*
  - **8 c**, *Sisteme GIS.*
  - **8d**, *Bazamente gjeodezike*
  - **9 d**, *Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet*
  - **9 e**, *Studime e projektme hidrogjeologjike*
  - **12 d**, *Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte komplekse si: hidrocentrale (per cdo fuqi te instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele per vepra hidroteknike, bazamente per ngarkesa te medha dhe objekte industriale*
  - **12 e**, *Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrifeta me mundesi lengezimi*
- **14**, *Studime e projektme te ndertimit te impianteve te ujrave te zeza. Kjo kategori jepet vetem per persona juridik (shoqeri/studio)*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet te sjellin Liçencat e rinovuara ne zbatim te ketij vendimi.***

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

**Argumentimi:** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORIA E KËRKUAR</i>	<i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
<b>3a</b>	Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	Bazuar në detyra e projektimit, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do të hartojë edhe projektin e ndertimit
<b>5b</b>	Projektim Furnizim me ujë –kolektorë shkarkimi.	Bazuar në detyra e projektimit, parashikohet realizimi , si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>5c</b>	Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në detyra e projektimit , parashikohet realizimi i i rrjetit te kanalizimeve ne zonat rurale
<b>8 – a</b>	Rilevime inxhinierike	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje azhornimin e rruges, të jepet plani I piketimit dhe verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8-b</b>	Rilevime inxhinierike kadastrale.	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje azhornimin e rruges, të jepet plani I piketimit dhe verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8-c</b>	Sisteme GIS.	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi në hartimin e projektit duhet të jetë i licensuar në sistemet GIS , pasi aplikacionet GIS ndihmojnë në për të realizuar dhe projektuar si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8-d</b>	Bazamente gjeodezike	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje studime gjeodezike dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9- d</b>	Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qendrushmeri të ulet	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje studime gjeologjike të trojeve dhe shpateve me qendrushmeri të ulet , përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9- e</b>	Studime e projekte	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje

	hidrogeologjike	studime hidrogeologjike , perpara fillimit te projektit te zbatimi si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>12-d</b>	Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte komplekse si: hidrocentrale (per cdo fuqi te instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele per vepra hidroteknike, bazamente per ngarkesa te medha dhe objekte industriale	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet te beje studime/vleresime te trojeve ku do te n dertohet rrjeti , perpara fillimit te projektit te zbatimi si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>12-e</b>	Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet e shpate me qendrushmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrifeta me mundesi lengezimi	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet te beje studime/vleresime te trojeve ku do te n dertohet rrjeti ne lidhje me qendrushmerin e tyre , perpara fillimit te projektit te zbatimi si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>14</b>	Studime e projekttime te ndertimit te impianteve te ujrave te zeza. Kjo kategori jepet vetem per persona juridik (shoqeri/studio)	Bazuar në detyren e projektimit, , ne sherbimin e kerkuar shoqeria duhet te jete e pajsiur me licencen per kategorine 14
<b>6-a</b>	Projektimi rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytesore	Bazuar në detyren e projektimit,, parashikohet realizimi i rrugëve rurale apo urbane, dytesore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9-a</b>	Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile-ekonomike deri 5 kate	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet te beje studime gjeologjike-inxhinierike te turlit e rendesishme perpara fillimit te projektit te zbatimi si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te drejtuesve teknik, përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, shoqeruar me Diplomë, CV dhe kontratat individuale te punes (të vlefshme),:**

- **1(nje) Projektues Inxhinier Ndertimi** me kat **3/a** Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate, **6/a** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- **1(nje) Projektues Vepra Hidroteknike me kat 5/ b**, Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi , me **kat 5/c** Projektim ujesjelles kanalizime urbane-rurale.
- **1(nje) Projektues Gjeodet** me **Kat 8 a, b, c, d** (Rilevime inxhinierike. Rilevime inxhinierike kadastrale. Sisteme GIS. Bazamente gjeodezike).
- **1(nje) Projektues gjeolog** me kat **9/a** (Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile-ekonomike deri 5 kate, **9/d** (Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet), **9/e** (Studime e projektme hidrogjeologjike)
- **1(nje) Inxhinier pergjegjes per eficencen e energjise**

**Argumentim:** : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

-Punimet per sherbimin e projekteve strukture kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndertimit do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) projektues inxhinier ndertimi** , pjese e stafit teknik

-Punimet per sherbimin e projektimit hidroteknik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve. Si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) hidroteknik** si pjese e stafit teknik.

-Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet** si pjese e stafit teknik.

-Punimet per sherbimin e projektimit te studimit gjeologjik parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeolog**, si pjese e stafit teknik

- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit teknik.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një CV të tij, nje pershkrim i pergjithshem i profilit te veprimtarise, te dhena te pergjithshme lidhur me eksperiencia dhe bashkepunime, ne permbushje te projekteve te ndryshme me natyre konsulence, ne fushen e projektimit.

**Argumentim:** Me ane te permbushjes se ketij kriteri Operatori ekonomik ben nje pasqyrim te te gjithë veprimtrise dhe punes se tij. E cila e ben me te besueshme ne permbushjen e sherbimit qe do te realizohet.

Një punësim mesatar i të paktën **20 (njetzet )** personave, për periudhën e **6 (gjashte mujve te fundit)** të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen

c) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen 6 muajve te fundit .

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë,ose **ekuivalenten e tyre** përfshirë:

a)Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertificate **ISO 9001 -2015** (e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

b) Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertificate **ISO 14001-2015** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë/OHSAS **18001-2007**, ekuivalente **ISO 45001-2018** (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

d) Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertificate **39001:2012** (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**Argumentim :** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:



“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në perputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Q.K.L. për “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim Mjedisor, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)

Operatori Ekonomik duhet të jetë licencuar nga Q.K.L. për “Shërbime ekspertize në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”

Për të përmbushur kriteret e sipërcituara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimit elektronik, licencat e mësipërme.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kualifikimet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës referuar detyrës së projektimit, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen, operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat përkatëse.

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

a). Në funksion të zbatimit të kontratës, kërkohet të jenë në dispozicion:

1 (nj) pajisje GPS me saktësi 0.25m+1 ppm RMS (Horizontal) / 0.50m + 1 ppm RMS (Vertical)

1 (nje) pajisje Total Station

1 (nje) Penetrometer Dinamik ose Sonde Shpimi për marrjen e karrotave gjeologjike

**Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:**

a) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh: *Fature tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuara.*

b) Për mjete që shënohen në regjistrat publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton *regjistrimin e mjetit/ certifikatë pronësie, siguracionin e mjetit, certifikatën e kontrollit teknik, , leje qarkullimi.*

c) Për mjetet e siguruar me qira, dokumentat e mesipërme duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse *noteiale të qirase/leasing/huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### **Komisioni**

**Ilir Vako (specialist Fushe)**

**Oltion Begollari (specialist Fushe)**